



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. _____, datë _____ 2022

**“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 967, DATË 25.10.2013, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ‘PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË
FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË
MBETJEVE’”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 967, datë 25.10.2013 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i vendimit të Këshillit të Ministrave ndryshon me përmbajtje si vijon: “Për përbërjen e Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve si dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të tij”.
2. Shkronjat c), dh), e) dhe ë) të pikës 4, shfuqizohen.
3. Pika 9/1 ndryshon si më poshtë vijon:
“9/1. Mbledhjet e Komitetit organizohen dhe asistohen nga sekretariati teknik, përbërja e të cilit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin”.
4. Në pikën 10 fjalët “...apo me situatat emergjente mjedisore të krijuara” hiqen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA